



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 20.05.2025

NR.09/ 3580 /2025

KONTRATË PËR PUNË
Riparim

Numri i kontratës:¹ 659-25-3510-5-3-6/C629; KKHE-25-011-5-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Energy A+ SH.P.K., Prishtinë, Veternik, Pn, Prishtine, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Riparim i ndriqimit publik te Varrezat e Deshmoreve me numër identifikues: 659-25-3510-5-3-6; KKHE-25-011-5-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Riparim i ndriqimit publik te Varrezat e Deshmoreve**

No.	Lot
1	Riparim i ndriqimit publik te Varrezat e Deshmoreve

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **7,887.50 €**; [Shtatë mijë e Tetëqindë e Tetëdhjetë e shtatë euro/50 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

-Neni 4

Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE**² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	XHEVDET BUSHI
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	20/05/2025
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	ADYL MORINA
Pozita:	DREKTOR MENAXHUES
Nënshkrimi:	
Data:	20.05.2025
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-3510-5-3-6/C629 ; KKHE-25-011-5-3-6

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është EUR.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	-Te gjitha përgjegjësitë rreth mos-kujdesit në vendpunishte bien mbi operatorin ekonomik kontraktues
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda [3] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë [3 dite pas nënshkrimit me ftesë të AK-së]
	17.2	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë [90] ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është [10%] e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Regjistri do të mbahet në terren nga menaxheri dhe kontraktuesi
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: n/a
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: Sigurimi i kualitetit/cilesise 10% e vleres se kontrates per 12 muaj
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [90] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është [365] ditë nga moment i pranimit
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen].

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Mosmarrëveshjet do të zgjidhen me mirekuptim në mes të kontraktuesit, menaxherit dhe njesisë kerkuese, në të kundërt do të vazhdojnë me gjykatë</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno të dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Komerciale- Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifik organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifik rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].